



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.670/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Ajshe Rexhepi nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Ajshe Rexhepi, kandidate për anëtarë e Kuvendit Komunal Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me shenjën ZL.Anr.670/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Ajshe Rexhepi, kandidate për anëtarë e Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik LDK, në ankesën e saj nuk ka pretenduar asnjë parregullsi përveç ka cekur disa vendvotime me numër:1902E/02R, 1902E/04R,1902E/07R,1914E/04D,1960E/01R,1920E/02R,1920E/03R,1920E/04R,1920E/06D,1920x/01R;03R;04R;05D,1921E/01R;02R;03R;04R;05D,1924E;01R;02R,1925E/01R;02R ,03R,04R,1926E01r;02R;03R;04D,1914E/01R;02R;03R,04D,1915E/04R,05R;06R,07D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli pas shqyrtimit të ankesës të ankueses gjeti se ankuesja nuk ka specifikuar asnjë parregullsi dhe se ankesa përmban vetëm përshkrimin e disa qendrave të votimit dhe disa vendvotime pa asnjë lloj kërkesë për PZAP. Prandaj Paneli ankesën e ankueses e konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankueses e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.670/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*